Kronikë

Sherr për parakalimin, qëllohet me armë makina në autostradën Durrës-Tiranë, shpallen në kërkim 2 vëllezërit (EMRAT)

Konflikti nisi pas një debati verbal për parakalimin me automjet. Nga të shtënat mbeti i lënduar shoferi 35-vjeçar.

Foto ilustrim

Redaksia
4 Gusht, 11:46 | **Përditesimi: 4 Gusht, 11:48**

Share

Një sherr për parakalimin e makinave ka çuar në përdorimin e armës së zjarrit në autostradën "Durrës-Tiranë".

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:00 të mëngjesit të datës 3 Gusht.

Në konflikt u përfshinë 3 persona. Sipas Policisë së Durrësit, u qëllua me armë makina me të cilën udhëtonte 35-vjeçari L.Sh. Nga të shtënat mbeti i lënduar shoferi 35-vjeçar, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

LEXO EDHE:
Sezoni turistik/ Mbi 24 mijë pushues dhe rreth 7 mijë automjete mbërritën në fundjavë në Portin e Durrësit

Policia ka identifikuar si autorë dy vëllezër, Emiljano dhe Elton Domi, 46 dhe 40 vjeç.

Konflikti nisi pas një debati verbal për parakalimin me automjet.

Njoftimi i Policisë së Durrësit:

Në vijim të veprimeve hetimore në lidhje me ngjarjen e ndodhur rreth orës 01:00 të datës 03.08.2025, në autostradën "Durrës-Tiranë", ku u qëllua me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte shtetasi L. Sh., 35 vjeç, specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës identifikuan dhe shpallën në kërkim shtetasit E. D., 46 vjeç dhe E. D., 40 vjeç, vëllezër, të dy banues në fshatin Xhafzotaj.

Nga hetimet e deritanishme dyshohet se pasi janë konfliktuar verbalisht, me 35-vjeçarin, për parakalimin me automjet, vëllezërit kanë qëlluar me armë zjarri, në drejtim të automjetit me të cilin lëvizte ai.

Nga të shtënat u dëmtua 35-vjeçari, i cili është jashtë rrezikut për jetën.

Punohet intensivisht për kapjen e 2 shtetasve të shpallur në kërkim.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

V.G.J /Shqiptarja.com

TAG: elton domi | emiljano domi | te shtena me arme | Durres

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 3 Gusht, 06:37

Çfarë mendoni për ndryshimet e propozuara me draftin për Kodin e ri Penal?

Jam pro | Jam kundër | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Monumenti lundrues francez 'Bel Espoir' ankorohet në portin e Durrësit, do të largohet më 6 gusht
4 Gusht, 12:23

Shkodër/ Të shtëna në bjeshkët e Munellës! 37-vjeçari: Kemi konflikt me një bashkëfshatar, gjeta tabelë me mbishkrimin 'Ik se do vdesësh'! Policia gjen 6 gëzhoja
3 Gusht, 10:19

VIDEO/ Arrestohet hajduti 'serial' në Durrës, vidhte vila, hotele e biznese! Kundërshtoi efektivët
2 Gusht, 12:39

Pas sherrit, 18-vjeçari qëllon me pushkë drejt banesës së komshiut në Krujë, vihet në pranga
2 Gusht, 11:10

Mbi 240 mijë pasagjerë përdorën Portin e Durrësit në 6-mujorin e parë të vitit, 1.9 milionë tonë mallra të përpunuar

Aldo Mustafa

2 Gusht, 10:42

Durrës/ Arrestohet 35-vjeçari që vidhte kabujt elektrikë të ndriçimit rrugor (EMRI)
2 Gusht, 09:32

Avokati i Popullit heton trajtimin e të burgosurve në paraburgimin e Durrësit, mes tyre edhe Erion Veliaj
1 Gusht, 12:54

Ankorohet në Portin e Durrësit anija luftarake turke e klasit 'Bajraktar', pjesë e misioneve të NATO-s! Largohet nesër (VIDEO)

Artur Korriku

1 Gusht, 11:24

VKM/ Qeveria vendos shpronësimin e pronave private që preken nga ndërtimi i Portit të ri në Porto Romano, mbi 815 milionë lekë kompensime në total
31 Korrik, 21:19

Durrës/ Gomonia e tyre po fundosej nga moti i keq, policia detare shpëton 5 persona
31 Korrik, 19:07

Shijak/ Trafik droge dhe organizatë kriminale në Itali, arrestohet durrsaku i dënuar me rreth 8 vite burg! Interpoli do e ekstradojë (VIDEO)
30 Korrik, 09:12

Plagosi 70-vjeçarin për lojën domino, arrestohet i moshuari në Durrës! U largua me thikë në dorë
29 Korrik, 08:58

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje